

VENDIM
Nr. 138, datë 15.11.2013

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE
SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “a” dhe 15 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, pasi shqyrtoi informacionin për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

Argumentet e shoqërisë janë të drejta dhe, gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr. 92, datë 6.9.2011 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti